



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 150, datë 05.05.2020

**PËR
DETAJIMIN DHE SHPËRNDARJEN E PUNONJËSVE ME KONTRATË NË DISA GJYKATA
PËR VITIN 2020**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 90 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në Ligjin nr. 88/2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 47, datë 22.01.2020 “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2020, në njësitë e qeverisjes qendrore”, i ndryshuar, si dhe në analizën e nevojave që kanë gjykatat për punonjës shtesë,

VENDOSI:

1. Të miratojë detajimin dhe shpërndarjen e punonjësve me kontratë në disa gjykata, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR